



**VENDIM**

**Nr.87 Datë 10.11.2009**

**PËR**

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR NDRYSHIMIN E LICENSËS SË  
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË SHOQËRISË  
HIDROINVEST 1 SH.P.K ME SERI PV08K, NR.66, LËSHUAR ME  
VENDIM TË BORDIT TË KOMISIONEREVE TË ERE-S NR.113,  
DT.24.09.2008**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 19, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 15 pika 4 gërmat “a” dhe “b” të “Rregullores për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.108, datë 09.09.2008, dhe nenit 18 pika 1, gërma “a”, të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin Nr.21, datë 18.03.2009, të Bordit të Komisionerëve, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 10.11.2009, mbasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë “HIDROINVEST 1” sh.p.k për ndryshimin e liçensës Nr.66, Seria PV08K, për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, lëshuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.113, datë 24.09.2008 dhe informacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, dhe konstatoi paraqitjen e plotë të dokumentacionit sic kërkohet nga “Rregullorja për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave”,

**Vendosi:**

1. Të fillojë procedurën për ndryshimin e liçensës me numër Nr.66, Seria PV08K, për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, lëshuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.113, datë 24.09.2008, të mbajtur nga shoqëria “HIDROINVEST 1” sh.p.k.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjehere.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**Kryetari i ERE-s  
Bujar Nepravishta**